REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 mars 2022
Nr. ref.:RK1971/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI210/21

Parashtrues

Darko Tasić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml.nr.138/2021, të 5 majit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Darko Tasić, i cili gjendet në vuajtje të dënimit në Burgun e Sigurisë së Lartë në Dyz, i përfaqësuar në Gjykatën Kushtetuese nga avokati Dejan A. Vasić (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml.nr.138/21] të 5 majit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 nëntor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 3 dhjetor 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).

7. Më 9 dhjetor 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës e dërgoi në Gjykatën Supreme.

8. Në po të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Prizren për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.

9. Më 14 dhjetor 2021, Gjykata Themelore në Prizren e dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.

10. Më 9 mars 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 26 prill 2018, Prokuroria Speciale ngriti Aktakuzën [KTS.nr.149/09] kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale *"Krime lufte kundër popullsisë civile"* në bashkëkryerje nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (në testin e mëtejmë: RSFJ) lidhur me nenin 152, paragrafi 2, pika 2.2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK), në lidhje me nenin 3 (c) të përbashkët për Konventën e Gjenevës të 12 gushtit 1949, neni 4 (2) (e) dhe (g) dhe (13) i Protokollit të Dytë të 8 qershorit 1977, Shtojcës së Konventës së Gjenevës të vitit 1949, si dhe ligjeve dhe normave të së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe *"Krime lufte kundër popullatës civile"* në bashkëkryerje nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së, lidhur me nenin 152, paragrafi 2, pika 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe në lidhje me nenin 3 (c) të përbashkët për Konventën e Gjenevës të 12 gushtit 1949 nga neni 4 (e), (8) dhe 3 (c) dhe neni 13 i Protokollit të Dytë të 8 qershorit 1977, Shtojcës së Konventës së Gjenevës të vitit 1949, si dhe ligjeve dhe normave të së drejtës zakonore ndërkombëtare, pasi që gjatë periudhës 25-27 mars 1999, në cilësinë e forcave policore rezervë të RSFJ-së apo forcave militare serbe, në bashkëkryerje, kishte marrë pjesë në marrjen e pasurisë, grabitjen dhe shkatërrimin e paligjshëm të pronës (djegie shtëpish) dhe vjedhje të përmasave të mëdha të cilat nuk justifikoheshin me nevoja ushtarake si dhe kishte marrë pjesë në përdhosjen e një numri të pacaktuar të trupave të pajetë.

12. Më 22 qershor 2020, Gjykata Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [K.nr.35/18] e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprave penale në bashkëkryerje si në vijim:

    i) *"Krime lufte kundër popullsisë civile"* duke i shqiptuar dënimin me burgim prej shtatë (7) viteve.
    ii) *"Krime lufte kundër popullatës civile"*, duke i shqiptuar dënimin me burgim prej gjashtëmbëdhjetë (16) viteve.

13. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [K.nr.35/18] e dënoi parashtruesin e kërkesës për veprat e lartcekura me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej njëzetë e dy (22) viteve.

14. Tutje, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [K.nr.35/18] obligoi parashtruesin e kërkesës që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën paushalle gjyqësore në vlerë prej 2000 (dy mijë) eurove, si dhe shumën prej 50 eurove në emër të kompensimit për viktimat e dhunës.

15. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të Kodit Penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta pranojë ankesën dhe ta modifikojë Aktgjykimin e kontestuar ashtu që i akuzuari të lirohet apo që vendimi të shfuqizohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.

16. Më 1 shtator 2020, Prokuroria Speciale dorëzoi përgjigje [PPS.nr.149/2019] në ankesën e parashtruesit të kërkesës pranë Gjykatës së Apelit, duke i propozuar refuzimin e ankesës si të pabazuar dhe vërtetimin e Aktgjykimit të ankimuar.

17. Më 30 nëntor 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [APS.nr.37/2020] aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës duke ndryshuar Aktgjykimin [K.nr.35/18] e Gjykatës Themelore për sa i përket kualifikimit juridik dhe lartësisë së dënimit, duke e shpallur parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale "*Krime lufte kundër popullatës civile*" nga neni 142 lidhur me nenin 22 Kodit Penal të RSFJ-së, në lidhje me nenin 3 (c) të Konventës së Gjenevës të 12 gushtit 1949, neni 4 (2) (e) dhe (g) (8) dhe (3) (c), (13) sipas protokollit II të 8 qershorit 1977 dhe të Shtojcës së Konventës së Gjenevës të vitit 1949. Lidhur me lartësinë e dënimit, përmes Aktgjykimit [APS.nr.37/2020] të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës u dënua me njëmbëdhjetë (11) vjet burgim ndërkaq pjesa tjetër e Aktgjykimit [K.nr.35/18] të Gjykatës Themelore mbeti e pandryshuar.

18. Përkitazi me kualifikimin juridik të veprës penale, përmes Aktgjykimit të lartcekur, Gjykata e Apelit theksoi se "*...kjo gjykatë e ka ndryshuar aktgjykimin për faktin se ka vlerësuar se bëhet fjalë për një vepër penale pasi që veprimet e ndërmarra nga i akuzuari, e që lidhen me marrjen e pasurisë, plaçkitjen, në shkallë të gjerë të pasurisë, makinerive bujqësore dhe mjeteve motorike, përdhosje të kufomave, dhe cenimin e dinjitetit janë ndërmarrë në kuadër të veprës penale nga neni 142 i KP të RSFJ-së, dispozita që zbatohen edhe me Konventën e Gjenevës dhe protokollin shtesë në kohën kur është kryer vepra penale RSFJ*".

19. Pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të dispozitave të procedurës penale për shkak se gjykata e shkallës së parë nuk i kishte analizuar dëshmitë individualisht dhe së bashku, Gjykata e Apelit e vlerësoi si të pabazuar duke konstatuar se Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Konkretisht, lidhur me analizimin e dëshmive, në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit u theksua se deklaratat e dëshmitarëve përputheshin mes vete dhe se Gjykata Themelore i kishte analizuar të gjitha deklaratat dhe kishte arsyetuar se ato lidheshin me njëra tjetrën.

20. Pretendimin ankimor të parashtruesit të kërkesës për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, respektivisht për ekzistimin e fakteve kontestuese në deklaratat e dëshmitarëve, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar. Kësisoj, në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit u theksua se nga deklaratat e dëshmitarëve ishte konstatuar kryerja e veprës penale në bashkëkryerje. Në arsyetim të Aktgjykimit të saj, Gjykata e Apelit deklaroi se vetëm fakti: "*... dhe në fshatrat e tjera të Kosovës...*" nuk ishte i mbështetur në prova.

21. Tutje, Gjykata i vlerësoi si të pabazuara pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e Kodit Penal dhe vendimin mbi dënimin. Për sa i përket kualifikimit juridik të veprës penale, Gjykata e Apelit në arsyetim të Aktgjykimit të saj vlerësoi se gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte zbatuar KPRK-në në kualifikimin juridik të veprës penale, pasi që nuk kishte zbatuar

ligjin më të favorshëm për të akuzuarin. Gjykata e Apelit, duke zbatuar ligjin më të favorshëm, dhe duke marrë parasysh faktin se Kodi Penal i RSFJ-së ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, vendosi se bëhej fjalë vetëm për një vepër penale pasi që veprimet e parashtruesit të kërkesës kishin të bëjnë me plaçkitje, në shkallë të gjerë të pasurisë, makinerive bujqësore e mjeteve motorike, përdhosje të kufomave dhe cenim të dinjitetit, veprime të cilat hyjnë në fushëveprimin e nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së. Lidhur me lartësinë e dënimit, Gjykata e Apelit në arsyetim të Aktgjykimit të saj vlerësoi se duke u bazuar në dispozitat e Kodit Penal të RSFJ-së, dhe pas vlerësimit të rrethanave rënduese siç ishin motivi, roli në bashkëkryerje dhe veprimet e tij gjatë periudhës në fjalë si dhe rrethanave lehtësuese si mosha e re e tij në kohën e kryerjes së veprës penale dhe faktin se nuk kishte pasur rol kryesor, me dënimin e përcaktuar përmbushej qëllimi i dënimit.

22. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [APS.nr.37/2020] të Gjykatës së Apelit duke pretenduar shkelje të Kodit Penal, duke propozuar që Aktgjykimi i lartcekur të ndryshohet ashtu që të dënuarit t'i shqiptohet dënim më i butë, si rezultat i ekzistimit të një dënimi maksimal më të butë.

23. Më 5 maj 2021, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Pml.nr.138/2021], refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës duke konstatuar se dënimi i të dënuarit është shqiptuar brenda minimumit dhe maksimumit të paraparë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: "*Pasojat e veprimeve të tij nuk kanë qenë aq të tmerrshme sa të meritojnë një dënim aq të lartë pasi që është dënuar për grabitje të intensitetit të ulët dhe trajtim çnjerëzor të mbetjeve njerëzore të personave të vrarë nga dikush tjetër*".

26. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se:

> "*Në fakt, me këtë vendim, në arsyetimin e saj Gjykata Supreme ka thënë se dënimi maksimal për veprën e krimeve të luftës në Kosovë është 15 vjet burg. Gjykata jep një shpjegim të saktë dhe preciz për një qëndrim të tillë. Të udhëhequr nga ky fakt dhe duke pasur parasysh se Gjykata e Apelit e përcaktoi dënimin e saj, duke llogaritur se dënimi maksimal për këtë vepër është 20 vjet, besoj se vendimi për dënimin duhet të ulet më tej.*"

27. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata zvogëlimin e dënimit.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Kodi Nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës

Neni 152
Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës

1. *Kushdo që shkel rëndë nenin 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dënohet me burgim së paku pesë (5) vjet ose me burgim të përjetshëm.*
2. *Shkelje e rëndë e nenit 3, të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949, do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtar kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në armiqësi, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe që nuk janë në gjendje të luftojnë për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose për ndonjë shkak tjetër:*

[...]
2.2. kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi nënçmues;
[...]

Neni 31
Bashkëkryerja

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.

Neni 80
Dënimi për bashkim të veprave penale

1. *Nëse kryesi me një apo me më shumë veprime kryen disa vepra penale për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë, gjykata së pari shpall dënime për secilën nga këto vepra, e pastaj për të gjitha këto vepra e shqipton dënimin unik.*
2. *Gjykata shqipton dënimin unik sipas këtyre rregullave:*
   2.1. nëse për ndonjërën prej veprave penale gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim të përjetshëm, atëherë e shqipton vetëm këtë dënim;
   2.2. se për secilën prej veprave penale gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet e pesë (25) vjetësh;
   [...]

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

Neni 361
Baza e aktgjykimit

1. *Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor*
2. *Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor.*

Kodi Penal i ish-RSFJ-së (1976)

Neni 22
Bashkëkryerja

Nëse disa persona kryejnë bashkërisht një akt kriminal duke marrë pjesë në aktin e kryerjes apo në një mënyrë tjetër, secili nga ata duhet të dënohet siç është paraparë për këtë vepër.

Neni 38
Burgimi

1. *Dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë dhe as më i gjatë se 15 vjet.*
2. *Gjykata mund të shqiptojë dënim me burgim prej 20 vjetësh për veprat penale që mund të dënohen me vdekje.*

[...]

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

30. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

> *Neni 47*
> *[Kërkesa individuale]*
>
> *1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*
>
> *Neni 48*
> *[Saktësimi i kërkesës]*
>
> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*
>
> *Neni 49*
> *[Afatet]*
>
> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]."*

31. Për sa i përket përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke e kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, [Pml.nr.138/2021], të 5 majit 2021, pasi që i ka shteruar mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

32. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

> *"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."*

33. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih, rastin KI04/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26, shih, gjithashtu, rastin KI175/20, parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

34. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "*qartazi e pabazuar*" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime "*të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*". Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkese të vlerësuar si "*qartazi e pabazuar*", dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si "*qartazi të pabazuara*" të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI40/20 me parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; dhe KI21/21, me parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021.

35. Në këtë kontekst, dhe në vazhdim, për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht, për të vlerësuar në rrethanat e këtij rasti nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht, do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës,

në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilat, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

36. Gjykata rikujton se esenca e rastit ndërlidhet me faktin se Gjykata Themelore kishte shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprave penale *"Krime lufte kundër popullsisë civile"* nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së lidhur me nenin 152, paragrafi 2, pika 2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në lidhje me nenin 3 (c) të përbashkët për Konventën e Gjenevës të 12 gushtit 1949, neni 4 (2) (e) dhe (g) dhe (13) i Protokollit të Dytë të 8 qershorit 1977, Shtojca e Konventës së Gjenevës të vitit 1949, si dhe ligjet dhe normat e së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe "*Krime lufte kundër popullatës civile*" në bashkëkryerje nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të RSFJ-së, lidhur me nenin 152, paragrafi 2, pika 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe në lidhje me nenin 3 (c) të përbashkët për Konventën e Gjenevës të 12 gushtit 1949 nga neni 4 (e), (8) dhe 3 (c) dhe neni 13 i Protokollit të Dytë të 8 qershorit 1977, Shtojca e Konventës së Gjenevës të vitit 1949, si dhe ligjet dhe normat e të drejtës zakonore ndërkombëtare. Përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës ishte dënuar me dënim unik prej njëzetë e dy (22) viteve burgim. Më pas, Gjykata e Apelit aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore për sa i përket kualifikimit juridik dhe lartësisë së dënimit duke e shpallur parashtruesin e kërkesës fajtor vetëm për kryerjen e veprës penale "*Krime lufte kundër popullatës civile*" nga neni 142 lidhur me nenin 22 Kodit Penal të RSFJ-së, në lidhje me nenin 3 (c) të Konventës së Gjenevës të 12 gushtit 1949, neni 4 (2) (e) dhe (g) (8) dhe (3) (c), (13) sipas protokollit II të 8 qershorit 1977 dhe të Shtojcës së Konventës së Gjenevës të vitit 1949, duke i caktuar dënim me njëmbëdhjetë (11) vjet burgim. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pranë Gjykatës Supreme të cilën kjo e fundit e refuzoi si të pabazuar.

37. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës e konteston Aktgjykimin [Pml.nr.138/2021] e Gjykatës Supreme, duke pretenduar në esencë shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si rezultat i interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit.

38. Fillimisht, Gjykata rikujton se pretendimet të cilat parashtruesi i kërkesës i ngritë në Gjykatë, të njëjtat i ka ngritur edhe para gjykatave të rregullta dhe që kanë të bëjnë kryesisht me shkelje të Kodit Penal, konkretisht lidhur me dënimin që i është caktuar.

39. Lidhur me këtë, Gjykata, fillimisht, rikujton se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vlerësuar nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë apo për të vlerësuar nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë pasur dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës (shih, në këtë drejtim, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-

57; KI110/19, parashtrues *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).

40. Në këtë kontekst, Gjykata në kuadër të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 shqyrton nëse procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, miratuar më 10 korrik 1991, shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI110/19, cituar më lart, paragrafi 41).

41. Gjithashtu, Gjykata thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato (shih rastet e Gjykatës: nr. KI87/20, parashtrues *Suva Rechtsabteilung, Aktvendim* për papranueshmëri i 13 prillit 2021, paragrafi 57; KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët,* Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI75/17, parashtrues *X,* Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 55; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).

42. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu, Gjykata vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", gjë që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin *Ballıktaş Bingöllü kundër Turqisë,* GJEDNJ, nr. 76730/12 i 22 qershorit 2021, paragrafi 75; *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011; si dhe rastet e cekura më lart KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).

43. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih, rastin e GJEDNJ-së *Pronina kundër Rusisë*, kërkesa nr. 65167/01, Vendimi për pranueshmëri i 30 qershorit 2005; dhe rastet e Gjykatës të cituara më lart KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 38; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).

44. Në këtë kuptim, Gjykata në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka theksuar se edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në aspektin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se

një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik e që mund të ketë rezultuar në *"konkluzione arbitrare"* apo *"qartazi të paarsyeshme"* për parashtruesin (shih rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc.*, Aktgjykim, paragrafi 83; *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 184/02, paragrafët 70-74 dhe 84; *Păduraru kundër Rumanisë*, nr. 63252/00, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë* [GC], kërkesa nr. 33202/96, paragrafi 108; *Koshoglu kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës cituar më lart KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57; dhe KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).

45. Në rastin konkret, Gjykata ka parasysh se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr.138/2021] të 5 majit 2021 e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit [APS.nr.37/2020] të Gjykatës së Apelit. Gjykata rikujton se në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës kontestoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit duke pretenduar shkelje të Kodit Penal.

46. Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës e konsideron problematik pikërisht faktin se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj saktë ka theksuar se dënimi maksimal për veprën penale të krimeve të luftës është pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim mirëpo që Gjykata e Apelit kishte përcaktuar lartësinë e dënimit duke u e llogaritur dënimin maksimal njëzetë (20) vjet burgim. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se në këtë mënyrë është shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, pasi që vendimi për dënimin duhet të ulet më tej.

47. Gjykata, duke i ndërlidhur pretendimet e parashtruesit të kërkesës me faktet e rastit konkret, gjen se për Gjykatën nuk është i kontestueshëm fakti se parashtruesi i kërkesës është dënuar për kryerjen e veprës penale *"Krime lufte kundër popullatës civile"* nga neni 142 lidhur me nenin 22 Kodit Penal të RSFJ-së, në lidhje me nenin 3 (c) të Konventës së Gjenevës të 12 gushtit 1949, neni 4 (2) (e) dhe (g) (8) dhe (3) (c), (13) sipas protokollit II të 8 qershorit 1977 dhe të Shtojcës së Konventës së Gjenevës të vitit 1949, dhe se këtë fakt nuk e konteston as parashtruesi i kërkesës. Për parashtruesin e kërkesës është e kontestueshme baza e llogaritjes së dënimit maksimal në përcaktimin e lartësisë së dënimit.

48. Sa i përket pretendimit të lartpërmendur lidhur me çështjen e dënimit maksimal, Gjykata rikujton konstatimin e bërë nga Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj si në vijim:

"Dispozita e nenit 38.1 e KP të RSFJ-së përcakton se dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë apo më i gjatë se 15 vjet. Në paragrafin 2 të të njëjtit nen thuhet se vetëm për veprat penale për të cilat është paraparë dënimi me vdekje, gjykata mund ta shqiptoj dënimin me burgim prej 20 viteve.

Me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 199/24 të datës 12.12. 1999, e cila ka hyrë në fuqi më 10.06.1999 dënimi me vdekje është hequr (neni 1.5) dhe në vend të së njëjtës nuk është paraparë dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 40 viteve.

Me ndryshimet në Rregulloren e mësipërme, me Rregulloren nr. 2000/59 të datës 27 tetor 2000, në nenin 1.5 u hoq dënimi me vdekje, kështu që pika 6 e të njëjtit nen parasheh se për çdo vepër penale për të cilën kërcënohej me dënim me vdekje sipas ligjit që ishte në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, dënimi do të jetë me burgim në kohëzgjatje ndërmjet minimumit të paparë me ligj për veprën penale në fjalë dhe maksimumit deri në 40 vjet. Megjithatë, neni 40 i dispozitave kalimtare thotë se kjo rregullore do të hyjë në fuqi më 27 tetor 2000 dhe se neni 1.6 do të zbatohet vetëm për ato vepra penale të kryera pas asaj date. Duke pasur parasysh parimin e ndalimit të efektit retroaktiv-prapaveprues të kodit penal, si dhe faktin që nuk ekziston bazë ligjore për shqiptimin e dënimit maksimal me burgim, si dhe parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm, Gjykata Supreme konstaton se për të gjitha veprat penale të krimeve të luftës dhe veprat penale të tjera të kryera deri më 27 tetor 2000 për të cilat Kodi i RSFJ-së është i zbatueshëm, dënimi maksimal me burgim është 15 vjet."

49. Tutje, lidhur me dënimin e shqiptuar ndaj parashtruesit të kërkesës nga ana e Gjykatës së Apelit, Gjykata vëren se Gjykata Supreme konkludoi se tani dënimi maksimal për parashtruesin e kërkesës është më i shkurtër, më i favorshëm si dhe brenda minimumit dhe maksimumit të parashikuar. Për më tepër, Gjykata Supreme konstatoi se: *"... Gjykata e shkallës së dytë e ka modifikuar aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën përkitazi me vendimin mbi dënimin, jo vetëm sepse kjo gjykatë ka konstatuar se dënimi maksimal për një vepër të tillë penale ishte më i ulët se ai i vendosur nga gjykata e shkallës së parë, por edhe sepse i dënuari u shpall fajtor vetëm për një vepër penale. Kjo ishte një nga arsyet për shqiptimin e një dënimi përgjysmë më të butë".*

50. Prandaj, Gjykata, në dritën e asaj që u tha më lart, konsideron se Gjykata Supreme gjatë procedurës i është përmbajtur parimeve të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç parashikohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe se ka vepruar në frymën e dispozitave përkatëse penale dhe nga kjo gjithashtu mund të konkludohet se nuk ka pasur shkelje të Kodit Penal, siç pretendon parashtruesi i kërkesës në kërkesë.

51. Gjykata rrjedhimisht konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka pasur përfitimet e procedurës kontradiktore; ai ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës të paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; e ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës; arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, prandaj, procedura, shikuar në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim i 7 korrikut 2019, paragrafi 42; si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).

52. Prandaj, Gjykata vëren se arsyetimi i Gjykatës Supreme, duke iu referuar kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, është i qartë

dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Pekinel kundër Turqisë,* të 18 marsit 2008, nr. 9939/02, paragrafi 55; shih, gjithashtu, në këtë aspekt, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).

53. Përfundimisht, Gjykata konkludoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, për shkak të interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit në fuqi me rastin e përcaktimit të dënimit janë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të *"shkallës së katërt";* dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 9 mars 2022, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Remzije Istrefi-Peci

Gresa Caka-Nimani